

1 E hënë, 31 janar 2022

2 [Konferencë për Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit nuk marrin pjesë në sallën e
5 gjyqit]

6 --- Seanca fillon në orën 9.30 paradite

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mirëdita.
8 Mirë se erdhët, të gjithë.

9 Zonja Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

10 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar
11 Gjykatës. Kjo është lënda KSC-BC-2020-07, Prokurori i
12 Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Kush janë
14 të pranishëm?

15 Zonja Bolici.

16 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.
17 Për ZPS-në, sot kemi stazhieren Helena Kruger. Dhe anëtarët e
18 tjerë të ekipit të ZPS-së janë po ata që kanë qenë në seancën
19 e fundit.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
21 Faleminderit.

22 Zoti Rees ose zoti Bowden. Nuk e di kush do të flasë?

23 Z. BOWDEN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, zoti Rees
24 vazhdon që të jetë nga larg. Këtu në sallë kemi zonjën
25 Stephenson, zotin Joseph Bowden dhe zonjushën Wigmore.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

2 Faleminderit.

3 Zoti Cadman.

4 Z. CADMAN: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.

5 Jemi po të njëjtët [në] ekip.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Dëgjuam

7 dëshmitarin e fundit ditën e fundit. Aso kohe, asnjëri prej

8 avokatëve të Mbrojtjes nuk ishin të gatshëm për ta mbyllur

9 paraqitjen e provave të tyre.

10 Trupi Gjykses dëshiron të nënvijëzojë se një vendim i

11 cili ende nuk është marrë sa i takon nxjerrjes nuk e pengon

12 Mbrojtjen që të mbyllë paraqitjen e provave sepse nuk ka të

13 bëjë më me thirrjen e dëshmitarëve të tjetër apo me prova të

14 tjera shtesë. Kjo përputhet edhe me mendimin tonë të datës 8

15 nëntor 2021. Për të lejuar që paraqitja e provave nga Mbrojtja

16 të ketë të hapur çdo mundësi për të ardhmen.

17 Të premten, 28 janar, Trupi Gjykses mori një vendim për

18 materialin P205, duke miratuar kërkesën e ZPS-së për të mos e

19 nxjerrë këtë material.

20 Mbrojtja ka diçka për të thënë dhe a është e gatshme për

21 të mbyllur paraqitjen e provave sot?

22 Zoti Rees.

23 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I nderuar

24 Gjykatës, mund të ngre një çështje?

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Nuk ju

1 dëgjoj.

2 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po punoja disa
3 çaste --

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Më falni
5 pak, sa të vendos kufjet.

6 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I nderuar
7 Gjykatës, ka një çështje sa i takon vendimit F00541. Unë
8 propozoj një mënyrë sesi të vazhdojmë e cila mendoj se mund të
9 na ndihmojë që të ecim me shpejtësi përpara.

10 Unë kërkoj leje që ta apeloj atë vendim dhe/ose një
11 vendim për ta rishqyrtuar sipas rregullit 79. Në rastin e
12 parë, dua të them diçka për afatin.

13 Jam në dijeni që rregulla 9 e Rregullores i jep në një
14 shkallë të gjerë fleksibilitet Trupit Gjykes për afatet. Po
15 kështu e di se sipas rregullës 75(2), ka një diskrecion të
16 Trupit Gjykes për të lejuar parashtrime të bëra gojarisht.

17 Unë propozoj, të nderuar Gjykatës, se mund të bëj tani
18 një kërkesë gojarisht për leje për apelim të këtij vendimi.
19 Mund ta bëj shumë shpejt tani.

20 [Anëtarët e Trupit Gjykes këshillohen]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pra, keni
22 ndërmend që të bëni, që të kërkonit gojarisht apelim tani?

23 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ka
25 Prokuroria qëndrim?

1 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ne kemi kundërshtim për kërkesën
2 e Mbrojtjes për leje për apelim por nuk kemi problem që ata ta
3 bëjnë këtë kërkesë gojarisht.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] E kisha
5 fjalën, a keni kundërshtim që kërkesa të bëhet gojarisht tani?

6 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
8 Cadman, po ju?

9 Z. CADMAN: [Përkthim] E kemi diskutuar këtë me zotin
10 Rees. Do t'i bashkohemi kërkesës për apel.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ka
12 Prokuroria ndonjë -- a e ka problem që të përgjigjet tani?

13 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Do të dëshironim që të dëgjonim
14 se cilat janë argumentet e Mbrojtjes për të cilat nuk jemi
15 njoftuar, por besoj se nuk e kemi problem që të përgjigjemi në
16 këtë moment, por duam t'i dëgjojmë ato fillimisht.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në
18 rregull.

19 Përpara se të parashtroni mocionin gojarisht, a ka gjë
20 tjetër që doni për të cilin ju duhet ta keni vendosur?

21 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jo.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

23 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] I nderuar
24 Gjykatës, kërkojmë leje për apelim për dy çështje.

25 Çështja e parë: A ka gabuar Trupi Gjykues në refuzimin e

1 nxjerrjes për Mbrojtjen të materialit i cili sipas pikëpamjes
2 së Mbrojtjes dëshmonte aspekte të cilat ishin në kundërshtim
3 me parashtrimet e Mbrojtjes për shtytjen në kryerjen e krimit.

4 Çështja e dytë: Në mungesë të nxjerrjes, a ka gabuar
5 Trupi Gjykues në arritjen e përfundimeve nga ky material i
6 cili ishte kundërshtues në parashtrimet e Mbrojtjes sa i takon
7 shtytjes në kryerjen e krimit.

8 Të dy çështjet kanë të bëjnë me paragrafin 20 të vendimit
9 me numër F00541. Por në kuadër të kontekstit, si Mbrojtja e
10 zoti Gucati ashtu edhe ajo e zotit Haradinaj e kanë ngritur
11 mundësinë se materiali 205 mund të jetë në gjendje që të
12 dëshmojë moskryerjen nga ana e ZPS-së të hapave hetimore
13 adekuat. Theksi vendoset tek fjala "mundet" sepse, siç është
14 pranuar, si nga Mbrojtja e Gucatit ashtu edhe ajo e Haradinajt
15 dhe madje dhe nga Trupi Gjykues, ne, sigurisht, nuk e kemi
16 parë materialin 205 apo përmbajtjen e këtij materiali. Ne
17 thjesht i kemi sjellë në vëmendje Trupit Gjykues mundësinë se
18 ky material mund të jetë në gjendje që të dëshmojë mosbërjen
19 të hapave hetimorë adekuat nga ana e ZPS-së.

20 Në paragrafin 20, që në fillim të këtij paragrafi, Trupi
21 Gjykues vëren se materiali 205 nuk përmban asnjë informacion
22 apo provë që do të sugjeronte ndonjë mangësi nga ana e ZPS-së
23 të dukshme pra. Paragrafi 20, megjithatë, nuk mbaron me kaq.
24 Por vijon duke shprehur këtë përfundim mbi materialin, që, në
25 veçanti, intervista e personit të tretë nga ZPS-ja dhe pyetjet

1 që ka bërë hetuesi i ZPS-së sugjerojnë që ZPS-ja po bën hapa
2 hetimorë të cilët duken se janë të arsyeshëm dhe profesionalë
3 në rrethanat përkatëse, përfshirë këtu dhe vlerësimin e
4 besueshmërisë së informacionit që është marrë nga autori i
5 materialeve 203, 204 dhe nga individit i intervistuar në
6 materialin 205.

7 Ky është konkluzioni mbi materialin të cilin Mbrojtja nuk
8 e kam parë ose nuk ka qenë në gjendje për të bërë parashtrime
9 lidhur me atë material i cili, siç duket në pamje të parë,
10 mund të ketë lidhje me parashtrimet që ka pasur ose do të
11 bëhet shtytje për kryerjen e krimit. Në mungesë të këtij
12 materiali është e pamundur për Mbrojtjen që të kuptojë
13 përmbajtjen apo dhe kontekstin.

14 Unë e di që kërkesa vlen për apel, nuk është qëndrim për
15 të argumentuar se ka pasur një gabim të tillë. Por Mbrojtja
16 vazhdimisht e ka sjellë në vëmendje të Trupit Gjykses çështjen
17 Edward dhe Lewis në Britaninë e Bashkuar të Britanisë së Madhe
18 përpara Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut,
19 aktgjykimi i datës 27 tetor 2004, në faqen 17 në veçanti, ku
20 GJEDNJ-ja në veçanti ka bërë të qartë se i akuzuari do të
21 duhej që të kishte pasur akses në të gjitha materialet e
22 vendosura përpara Gjykatës sa i takon fakteve të cilat mund të
23 kishin lidhje me pretendimin për nxitje në kryerjen e krimit,
24 përfshirë edhe materialet që mund të ishin të kundërta me
25 qëndrimin e të pandehurit lidhur me këtë. Këto nuk përputhen

1 me kriteret e vendosura për barazinë e palëve dhe çojnë në
2 shkelje të nenit 6 të Konventës.

3 Këto dy aspekte janë aspekte apo çështje të apelueshme.
4 Ato nuk janë abstrakte apo hipotetike. Rrjedhin drejtpërdrejtë
5 nga vendimi. Në mënyrë të ndjeshme cenojnë zhvillimin e drejtë
6 dhe të shpejtuar të procedurës dhe kërkojnë një zgjidhje të
7 menjëhershme nga Dhoma e Apelit.

8 Ne themi se nga që përbëjnë një -- nga që jemi në një
9 pikë kritike të gjykimit. Kjo është e rëndësishme. Kjo është
10 hera e fundit që i jepet mundësi Mbrojtjes përpara të trajtuar
11 çdo cenim i cili mund të lind nga konkluzione dëmtuese të
12 cilat mund t'i marrë Trupi Gjykues nga materiali i cili nuk i
13 është treguar Mbrojtjes, prandaj dhe ne kërkojmë leje për të
14 apeluar vendimin.

15 Ose në mënyrë alternative, themi që Trupi Gjykues duhet
16 të rikonsiderojë, ta rishqyrtojë vendimin e vet sipas
17 rregullit 79. Ky rregull i jep kompetencën për të rishqyrtuar
18 në rast të nevojës për të shmangur padrejtësi. Ne themi se ka
19 një gabim të qartë në vendimin që i treguar Mbrojtjes i cili
20 cenon në parashtrimin e tij për shtytjen në kryerjen e krimit
21 dhe se rishqyrtimi i refuzimit për të nxjerrë duhet të kryhet
22 për të shmangur çdo padrejtësi të këtij përfundimi që për t'u
23 dhënë mundësinë Mbrojtjes që të ketë mundësinë ta kundërshtojë
24 apo ta trajtojë në këtë kontekst.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Zoti Cadman.

3 Z. CADMAN: [Përkthim] Ne, si Mbrojtje e zotit Haradinaj,
4 i bashkohemi këtyre parashtrimeve. Nuk kemi gjë tjetër për të
5 shtuar.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

7 Faleminderit.

8 Do t'ju bëj dhe një pyetje tjetër Mbrojtjes. Veç kësaj
9 çështjeje, që ende mbetet që të marrë zgjidhje asnjë prej
10 ekipeve të Mbrojtjes nuk ka dëshmitar tjetër për të thirrur.
11 Kështu?

12 Z. CADMAN: [Përkthim] Kjo është e saktë, i nderuar
13 Gjykatës.

14 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Kjo është e
15 saktë, i nderuar Gjykatës.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pra, në
17 varësi të vendimit që do të marrim, të cilin do ta marrim me
18 shkrim ose sot më vonë gjatë ditës ose nesër, do t'ju kërkohet
19 që ta mbyllni paraqitjen e provave zyrtarisht, siç ju thashë,
20 në varësi të mënyrës sesi do të jetë ky vendim.

21 U kuptuam?

22 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Patjetër, i
23 nderuar Gjykatës.

24 Z. CADMAN: [Përkthim] Patjetër, i nderuar Gjykatës.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zonja

1 Bolici, tani mund t'ju dëgjojmë dhe juve.

2 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ne do t'i shprehim pas shumë pak
3 kohe në sallë kundërshtimet që kemi për kërkesën e Mbrojtjes.

4 Në lidhje me çështjen e parë që u theksua nga Mbrojtja e
5 Gucatit ne parashtrojmë se Mbrojtja thjeshtë nënvijëzon
6 mospajtim pa ndonjë arsytim sa i takon këtij gabimi.

7 Sa i takon çështjes së dytë, ne vërejmë se çështja nuk
8 del nga vendimi i Trupit Gjykues. Mbrojtja e Gucatit, në fakt,
9 kundërshton kornizën ligjore që mbulon këtë Gjykatë dhe nuk
10 argumenton, në argumentimet e veta, më saktë, nuk tregon se ky
11 material, nxjerrja e të cilit është kundërshtor, do të ishte
12 kundër rregullave apo kuadrit ligjor. Në fakt, rregullat 102
13 dhe 108 të Rregullores shprehimisht parashikojnë procedurën që
14 duhet ndjekur jo me kundërshtimin e vendimit por kundërshtimin
15 e rregullores në fund.

16 Së fundi, sa i takon mundësisë për një apelim, Prokuroria
17 vëren se duke pasur parasysh se jemi në një etapë të vonshme,
18 pra, të fundit të procedurës ka mbaruar dhe paraqitja e
19 provave. Një apel i ndërmjetëm në këtë rast, në këtë etapë,
20 nuk do ta çonte përpara por përkundrazi do ta vononte ndjeshëm
21 ecjen përpara të kësaj procedure. Dhe ZPS-ja ka mbrojtur
22 gjithmonë idenë se ky proces gjyqësor duhet të mbyllet sa më
23 shpejt.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Ne do ta shqyrtojmë kërkesën për certifikim, për leje
2 pra, e cila është parashtruar gojarisht dhe do të marrim një
3 vendim.

4 Do të vazhdojmë edhe me parashtrimet e tjera që do bëhen
5 sot duke e ditur që këtë kërkesë për certifikim e kemi marrë
6 tashmë.

7 Trupi Gjykses do të dëgjojë parashtrime për hapat në
8 vijim. Kemi vendosur disa pyetje në agjendën e protokolluar
9 javën që shkojë që është me numër F27. Parashtrimet me shkrim
10 janë marrë nga të dy ekipet e Mbrojtjes, kështu që do të
11 marrim me radhë pyetjet përkatëse.

12 Do të fillojmë me faktet për të cilat palët pajtohen.
13 Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja e zotit Haradinaj ka bërë të
14 ditur në parashtrimet me shkrim se është dakord me 13 faktet
15 paraprahe për të cilat ka rënë dakord Mbrojtja e Gucatit me
16 ZPS-në në procedurën paraprahe.

17 Zoti Cadman, do të thotë kjo se ju nuk jeni dakord, pra,
18 nuk pajtoheni me faktin tjetër për të cilin ka rënë dakord
19 Mbrojtja e Gucatit me ZPS-në dhe që është riprodhuar dhe në
20 mocionin për praninë e provave jashtë, pra, pa marrë
21 dëshmitarët në pyetje?

22 Z. CADMAN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, mund të ketë
23 një farë pështjellimi. Siç e kuptova unë, neve na u kërkuar
24 nëse pajtohemi për të gjitha faktet që ekipi i Gucatit ka rënë
25 dakord me Prokurorinë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
2 çaktivizuar].

3 Z. CADMAN: [Përkthim] Po.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e
5 Gucatit ka bërë të ditur në parashtrimin e vet se është
6 dakord, pra, se pajtohet me tre faktet për të cilat është
7 pajtuar ekipi i Mbrojtjes së Haradinajt më ZPS-në gjatë
8 procedurës paraprake. Të dyja ekipet e Mbrojtjes tregojnë se
9 faktet për të cilat ata pajtohen mund të bëhen publike dhe
10 s'ka fakte të tjera për të cilat janë pajtuar.

11 Trupi Gjykses i falënderon parashtrimet.

12 Zonja Bolici, keni gjë për të shtuar? Në veçanti, cilat
13 janë parashtrimet tuaja sa i takon klasifikimit të një fakti
14 shtesë për të cilin është pajtuar Mbrojtja e Gucatit me ZPS-
15 në?

16 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Mund të jetë publik dhe nuk kemi
17 gjë tjetër për të ngritur në këtë moment.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në
19 rregull. I mbajtëm shënim.

20 Në agjendë i kemi ftuar palët që të marrin, që të
21 mendojnë për parashtrimin për të pranuar në provat gjyqësore
22 disa materiale të caktuara të cilat ose janë përdorur në
23 Gjykatë, pra, nuk janë kërkuar që të pranohen ose përfshirë në
24 listat e palëve po s'janë përdorur. Bëhet fjalë për këto
25 materiale: DHG0075 deri në DHG0081, që është një deklaratë e

1 vitit 2014 e Kryeprokurorit të TFHS-së dhe ka qenë në listën e
2 provave të Mbrojtjes së Gucatit; pastaj janë disa pjesë të
3 aktgjykimit të TPNJ-së në çështjen Haradinaj; dhe, disa pjesë
4 të një aktgjykimi të një gjykate kosovare të datës 10 gusht
5 2006 e përdorur nga ZPS-ja gjatë kundrapyetjeve, me numër ERN
6 SPOE00248303 deri në 00248304.

7 Trupi Gjykses e ka bërë këtë ftesë si një hap të parë
8 sipas rregullit 132 të Rregullores.

9 Trupi Gjykses vëren se një pjesë e aktgjykimit të TPNJ-së
10 së Haradinajt është pranuar në prova të premtën.

11 Mbrojtja e Gucatit parashton se nuk dëshiron që të
12 kërkojë për pranim në provat gjyqësore të deklaratës së
13 Kryeprokurorit dhe se kundërshton pranimin e aktgjykimit të
14 Gjykatës së Kosovës.

15 Mbrojtja e Haradinajt parashton se nuk parashikon që të
16 prezantojë prova të tjera dhe nuk kërkon që të pranohen në
17 prova gjyqësore asnjë prej këtyre materialeve.

18 Ka ZPS-ja ndonjë mendim?

19 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ne i kemi përcjellë Mbrojtjes që
20 më 21 janar 2022 gatishmërinë për t'i pasur të gjitha këto
21 materiale të pranuar në prova gjyqësore. S'kemi dëgjuar asnjë
22 mendim prej tyre deri të premtën. Ne mbajmë të njëjtin
23 qëndrim.

24 Sa i takon aktgjykimit që është lexuar në Gjykatë, ZPS-ja
25 mban qëndrimin se ato pjesë të atij aktgjykimi janë në

1 procesverbal dhe nëse pranimi i aktgjykimit në provat
2 gjyqësore është i nevojshëm për të konfirmuar se po këto pjesë
3 të aktgjykimit janë cituar saktë dhe se ekziston në të vërtetë
4 ky aktgjykim, atëherë ky aktgjykim do të duhet që të pranohej
5 në prova gjyqësore. Faleminderit.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti Rees,
7 keni diçka për të shtuar?

8 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Sa i takon
9 gjësë së fundit që tha zonja Bolici për pjesët e aktgjykimit
10 nga SPOE00248303 deri në 00248304, sigurisht, pyetjet e zonjës
11 Bolici nuk janë prova. E vetmja provë aty vjen nga ato pjesë
12 të cilat janë përgjigje të dëshmitarit.

13 Ne nuk kërkojmë parashtrim të deklaratës së
14 Kryeprokurorit të 2014-s. Nuk e kemi përdorur ose nuk e kemi
15 kërkuar që të pranohet në prova gjyqësore përmes asnjë
16 dëshmitari.

17 Në paragrafin 6 të aktgjykimit të Haradinajt, sa i takon
18 pra, paragrafi 6 i aktgjykimit të Haradinajt të datës 3 prill
19 2008, është pranuar tashmë, të nderuar Gjykatës, përmes një
20 urdhri të dhënë gojarisht të premtën.

21 Vetëm një ekzaminim i kujdesshëm i asaj pjese ka të bëjë
22 me fjalinë e parë. Pra, në fakt, kjo është një koment që ka të
23 bëjë në mënyrë specifike me ata individë të cilët kanë dhënë
24 dëshmi në çështjen me numër 85/2005. Pjesa tjetër që mbetet e
25 këtij pasazhi të lexuar nga zonja Bolici ishte thjesht një

1 riciklim të themi i një citimi nga një tjetër çështje
2 gjyqësore e TPNJ-së, me numër IT-03-63-T.

3 Mbrojtja, pra, nuk pasur mundësi që të prapësojë ndonjë
4 pjesë të kësaj deklarate nëse ka qenë apo jo e saktë e tjerë
5 sa i takon 2005, 2006. Kjo nuk mund të themi që mund të jetë
6 provuese për frikësim të dëshmitarëve.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

8 Faleminderit, zoti Rees.

9 Zoti Cadman, do të shtoni ndonjë gjë?

10 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Të tjerët
12 kanë ndonjë gjë? Jo. Mirë. Faleminderit.

13 Trupi Gjykses do të marrë vendim në momentin e duhur sa i
14 takon ushtrimin të tagrit të vet sipas rregullit 132 dhe
15 *proprio motu* i pranon këto materiale në provat e pa vëna në
16 dispozicion nga palët.

17 Vazhdojmë me temën tjetër. Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja
18 ka treguar të premtën se me shumë gjasë nuk do të kërkojë që
19 të marrë leje për të parashtruar kundërprova.

20 Kështu është?

21 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

23 Faleminderit.

24 Duke qenë se ZPS-ja nuk synon që të paraqesë kundërprova
25 atëherë nuk ka nevojë të diskutojmë as për leje për Mbrojtjen

1 për të paraqitur kundërprova.

2 Kalojmë tani tek dosjet gjyqësore përfundimtare. Në
3 konferencën përgatitore të Mbrojtjes, të gjitha palët bënë të
4 ditur një vlerësim paraprak tre javor nga mbyllja e paraqitjes
5 së provave për të protokolluar dosjet gjyqësore përfundimtare.

6 Në parashtrimet me shkrim, të dy ekipet e Mbrojtjes e
7 kanë rishikuar këtë vlerësim dhe kërkojnë 30 ditë nga mbyllja
8 e paraqitjes së provave.

9 Trupi Gjykses vëren se 30 ditë është afati maksimal që
10 parashikon rregulli 154 shkronja (b). Mbrojtja parashtron se e
11 rishikon vlerësimin për shkak të provave të konsiderueshme
12 shtesë të ekspertëve që janë dëgjuar nga Trupi Gjykses për
13 shkak të vendimit të Panelit të Gjykatës së Apelit.

14 Në këtë aspekt, Trupi Gjykses ka dy gjëra për të thënë.
15 Së pari, dëshmitë e ekspertëve janë thirrur nga Mbrojtja,
16 prandaj dhe bien brenda objektit të ekspertizës së dëshmitarit
17 të tyre. Së dyti, vërejmë se vlerësimi që ka dhënë Mbrojtja
18 është dhënë në konferencën përgatitore të Mbrojtjes përpara
19 përmbledhjes së vendimit në fjalë të zotit Reid.

20 Megjithatë, duke pasur këtë parasysh, do të donim të
21 dëgjonim nga Mbrojtja çfarë ka pasur kaq të papritur në
22 dëshminë e ekspertëve që e ka ndryshuar kaq shumë vlerësimin e
23 tyre.

24 Zoti Rees.

25 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Së pari, i

1 nderuar Gjykatës, parashtrimi nuk është që të kërkonim 30 ditë
2 për protokollimin e dosjes gjyqësore përfundimtare pas
3 mbylljes së paraqitjes së provave. Ne kemi kërkuar një
4 periudhë më të gjatë sesa 21 ditë deri në 30 ditë, duke pasur
5 parasysh edhe shkurtimin e periudhës për deklaratat
6 përmbyllëse gjithashtu.

7 Ajo që do t'i kërkonim Trupit Gjyqësor është që të mendojë
8 vendosjen e një afati paraprak disi më të gjatë për deklaratat
9 përmbyllëse dhe pastaj në bazë të kësaj të vendosim edhe
10 afatet e tjera.

11 Më datë 2 dhjetor, se dua që t'i kthehem afatit 21 ditor.
12 Kjo u propozua paraprakisht nga ZPS-ja pa i bërë ndonjë
13 njoftim paraprak Mbrojtjes dhe ne në këtë moment u pajtuam se
14 mundet, mbase, mund të ishte e mundshme që të përmbushnim këtë
15 afat 21 ditor.

16 Sigurisht, është më se e saktë që në atë moment, i
17 nderuar Gjykatës, mbyllja e paraqitjes së provave parashikohej
18 të ishte 17 dhjetori. Mirëpo kjo u shty më 2 dhjetor për 17
19 janarin. Pastaj u shty prapë dhe sigurisht, ndodhemi, pra, u
20 shty për 28 janarin dhe jemi sot në këtë datë.

21 Kemi që më 18 tetor të gjitha palët mendonin se do të
22 ishim gati me të gjitha këto më 2 dhjetor. Kjo, sigurisht, mos
23 të harrojmë që kërkon një shkallë të madhe që të rilexojmë
24 transkriptet, të bëjmë analizat përkatëse dhe të vëmë në punë
25 dhe kujtesën tonë. Parashitshmëri, se në rrethanat përkatëse,

1 është më se e përshtatshme një afat paksa më i gjatë sa më i
2 gjatë se 21 ditët për të cilat u propozuam më 2 dhjetor.

3 I nderuar Gjykatës, ju, siç jeni në dijeni nga
4 parashtrimet tona, ne kemi kërkuar për një datë të re
5 paraprake për deklaratat përmbyllëse që të jetë 14 marsi. Kjo
6 nuk është një zgjatje e konsiderueshme e datës së mëparshme të
7 synuar që ishte data 1 mars. Ne parashtrojmë nëse çështjet do
8 të zgjateshin me një periudhë dy javore, kjo do të ishte
9 proporcionale, do të ishte e arsyeshme dhe do të na jepte
10 mundësi, do të na jepte një kohë shtesë për të pasur kohë edhe
11 për dosjen gjyqësore përfundimtare dhe për të përgatitur
12 deklaratat përmbyllëse, për t'ju përgjigjur asaj që do të
13 vendosni në dosjen gjyqësore përfundimtare Prokuroria.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do t'ju
15 bëj një pyetje juve tani zoti Rees. Do t'ia bëj pyetjen edhe
16 zoti Cadman edhe Prokurorisë më vonë.

17 Që nga dita e fundit e shkurtit deri më datë 14 mars, a
18 jeni ju disponibël për të gjithë periudhën nëse ne caktojmë
19 një datë çfarëdo aty?

20 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Do të
21 kontrolloj një moment, ju lutem.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në
23 rregull.

24 Edhe ju, zoti Cadman, mund të bëni të njëjtin verifikim.

25 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Kam një

1 angazhim tjetër profesional në javën që fillon më datë 7, të
2 nderuar Gjykatës.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pra, të
4 gjitha, pra, këto dy javë ju jeni disponibël me përjashtim të
5 datës 7?

6 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po është java
7 që fillon -- është java nga 28 shkurti dhe pastaj java që
8 fillon 14 marsi.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në
10 rregull.

11 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Unë edhe në
12 javën që fillon më 21 mars jam disponibël.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mund të
14 jetë pak larg ajo.

15 Z. CADMAN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, unë nuk jam
16 disponibël nga data 14 deri në datë 18 shkurt. Dhe nuk jam
17 disponibël më 28 shkurt, por jam disponibël gjatë gjithë
18 marsit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mua më
20 duket se kishim lënë një seancë për 28 shkurtin.

21 Z. CADMAN: [Përkthim] Po, mund ta rregulloj punën që të
22 jem disponibël për atë ditë por thjesht tregova se si i kam
23 angazhimet.

24 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, qëndrimi i
25 ZPS-së është që s'ka asnjë ndryshim në rrethana pas

1 vlerësimeve të parashtruara në dhjetor që të justifikonte një
2 zgjatje shtesë të kësaj procedure.

3 ZPS-ja ka argumentuar që në fillim, se faktet e kësaj
4 çështjeje janë të thjeshta. Çështjet juridike janë trajtuar si
5 me parashtrime shkrim ashtu dhe të bëra gojarisht. Mbrojtja i
6 ka pasur burimet e mjaftueshme në dispozicion dhe argumentet
7 që ato kanë dhënë për të kërkuar shtytjen e afatit janë të
8 pabaza në kuptimin që objekti i provave që është prezantuar
9 është pikërisht ai që ka qenë më përpara. Fakti që këto janë,
10 paraqitja e provave ka kërkuar më shumë kohë për shkak të
11 vonesave që kanë ardhur nga padisponueshmëria e Mbrojtjes nuk
12 përbën justifikim për një vonesë shtytje të mëtejshme të kësaj
13 procedure.

14 E kjo cenon edhe interesat e të akuzuarve do të thosha
15 unë dhe ky është qëndrimi i ZPS-së.

16 Prandaj, ne mendojmë se palët duhet të jenë gati që të
17 protokollojmë dosjet gjyqësore përfundimtare brenda 21 ditësh
18 nga mbyllja e paraqitjes së provave dhe pas kësaj mund të
19 bëjmë dhe deklaratën përmbyllëse.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Dhe ju nuk
21 ndonjë ditë që nuk jeni e disponueshme apo jo?

22 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Jo. ZPS-ja është e disponueshme
23 gjatë gjithë kohës.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
25 Cadman.

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Mu kërkua që të thoja në qoftë se
2 kam ndonjë parashtrim apo jo. Pa diskutim, që nuk është se dua
3 të përsëris atë çfarë tha zoti Rees. Por kur u dha një indicie
4 në konferencën e përgatitjes së Mbrojtjes, neve thamë që ishte
5 një ditë e parashikuar, ndërkohë që kam dy komente lidhur me
6 këtë. Disa prej çështjeve të cilat kanë ndodhur që prej asaj
7 kohe, pra, bëjnë të arsyeshme këtë zgjatje të kohës.

8 Dhe dua ta bëj të qartë, që ne nuk po kërkojmë
9 parashtrimin e dosjes sonë gjyqësore duke thënë që nuk jemi të
10 disponueshëm. Nuk është arsyeja kjo pse po kërkojmë shtyrje të
11 kohës. Kështu që zonja Bolici duke iu referuar burimeve të
12 Mbrojtjes dhe disponueshmërisë tonë, dua të them që arsyet
13 tona nuk janë se ne nuk jemi të disponueshëm por janë arsye të
14 cilat i përmendëm më sipër. Pra, ne e kemi rishikuar
15 vlerësimin paraprak që na u dha. Dhe ky është pozicioni jonë
16 sa i takon datës apo kohës së parashtrimit në dosjes
17 gjyqësore.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

19 Faleminderit, zoti Cadman. Nuk doja që t'ju harroja.

20 Pra, siç do të doja të theksoja edhe njëherë, që
21 parashtrimet me shkrim në dosjen përfundimtare gjyqësore duhet
22 të jenë koncize. Duhet të jenë të përqendruara, duhet të jenë
23 të lidhura me faktet, me çështjet dhe rrethanat e ndryshme të
24 cilat janë të rëndësishme për sa i takon çështjes në fjalë.
25 Dhe nuk duhet të jenë me deklarata politike, pra, siç e kemi

1 thënë shpesh herë, deklaratat politike duhet të shmangen.

2 Sa i takon deklaratave përmbyllëse. Në konferencën për
3 përgatitjen e Mbrojtjes, të gjitha palët vlerësuan për sa i
4 takon argumenteve përmbyllëse. Dhe e di që këtë çështje ne, në
5 fakt, e trajtuam tani. Megjithatë, në parashtrimet e tyre me
6 shkrim të dyja ekipet e Mbrojtjes rishikuan vlerësimet e tyre
7 të përafërta. Ndërkohë që Mbrojtja e Haradinajt kërkoi 14 ditë
8 dhe Mbrojtja e Gucatit kërkoi 21 ditë.

9 Dhe Trupi Gjykues vëren se 21 ditë është koha maksimale
10 në përputhje me rregullin 134(d).

11 Pra, përpara sesa t'ju kërkoj palëve rreth arsyeve për
12 kohët e përafërta të vlerësuar prej tyre, Trupi Gjykues i
13 kujton të gjithë që deklaratat përmbyllëse duhet që të
14 shmangin përsëritjet, të mos përsëriten parashtrimet të cilat
15 janë bërë më përpara dhe ndërkohë që Trupi Gjykues mund të
16 ketë pyetje për të bërë edhe gjatë kësaj kohe po ashtu.

17 Zonja Bolici, sa kohë ju duhet për deklaratat
18 përmbyllëse?

19 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ne fillimisht kishim menduar për
20 katër orë, i nderuar Gjykatës, sa i takon paraqitjes ose
21 prezantimit të deklaratës përmbyllëse. Dhe ne vlerësojmë që do
22 ta respektojmë këtë kohë në qoftë se nuk ka ndonjë gjë të
23 paparashikuar dhe që do të duhet që të trajtojmë ndonjë
24 çështje shtesë të parashtrimeve të Mbrojtjes.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Zoti Rees, a mund të na jepni një vlerësim të përafërt të
3 kohës që ju nevojitet?

4 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Sa i takon
5 kohës që kërkohet në parashtrimin tonë përfundimtar, ne nuk
6 kemi kërkuar për 21 ditë. Ne, në fakt, kemi kërkuar javën e 14
7 marsit për deklaratat përmbyllëse dhe kemi kërkuar që
8 llogaritjen ta bëjmë prej asaj kohe mbrapsht sa i takon
9 parashtrimin të përfundimtare gjyqësore.

10 Sa i takon kohës së nevojshme. Kemi vlerësuar nëntë orë.
11 Ndërkohë Prokuroria vlerëson katër orë. E kemi bërë këtë
12 vlerësim mbështetur në faktin që, ndër të tjera, ne do të na
13 duhej që të kalojmë disa prej provave materiale të cilat nuk
14 janë pranuar formalisht, zyrtarisht, akoma. Për shembull, e di
15 që Trupi Gjyqësor ka transkripte të gjata nga intervistat dhe
16 konferencat për shtyp, pra, janë aspekte të provave të tilla
17 të cilat unë do të doja që t'i parashtroja në deklaratën
18 përmbyllëse të çështjes.

19 Kështu që sa i takon vlerësimin të kohës që na duhet për
20 këtë gjë, mendoj, që është një vlerësim i mirë dhe i drejtë.
21 Dhe do të mundohem që ta përmirësoj këtë vlerësim dhe
22 sigurisht, që do ta shkurtoj në qoftë se do të mundem. Por
23 dua që të më lejohet që të më jepen, pra, nëntë orë në
24 dispozicion në mënyrë që të parashtroj deklaratën përmbyllëse
25 të çështjes.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mund të
2 kemi disa pyetje lidhur me të.

3 Zoti Rees, nuk e di kishte ndonjë gjë tjetër për të
4 shtuar?

5 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk ju dëgjoja
6 dot, thjesht ju pashë po flisnit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ishte faji
8 im.

9 Z. CADMAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne kemi thënë
10 që në këtë fazë, pra, e kemi thënë që sa kohë na duhet.
11 Sigurisht, domethënë, nuk dua që ta komplikoj këtë çështje më
12 dhe nuk dua që të kalojmë material të cilin ne e kemi trajtuar
13 deri tani. Pra, neve do të na nevojitej ndoshta gjysmë dite,
14 jo më shumë sesa dy sesione, në mënyrë që të parashtrojmë
15 deklaratën tonë përmbyllëse.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Jo më
17 shumë sesa dy sesione.

18 Siç mund ta shihni, kemi vështrime të ndryshme sa i takon
19 kësaj çështjeje, do ta shqyrtojmë dhe do t'ju japim mendimin,
20 vlerësimin tonë.

21 Tani kalojmë tek tema tjetër. Në pajtim me paragrafin 6
22 të rregullit 159, në qoftë se Trupi Gjykses e gjen të
23 akuzuarin fajtor për një ose më shumë vepra penale Trupi
24 Gjykses përcakton dënimin e duhur për të akuzuarin që
25 shqiptohet në vendimin e gjykimit.

1 Përveçse të ketë dëgjuar palët, Trupi Gjykses, vendos të
2 procedojë në përputhje me rregullën 162 dhe kjo është e drejtë
3 e Trupit Gjykses.

4 Duke ditur që një vendim i tillë ka ndikim mbi
5 përmbajtjen e dosjes përfundimtare gjyqësore dhe të
6 deklaratave përfundimtare, Trupi Gjykses vlerëson të
7 përshtatshme që të marrë parashtrimet nga palët në këtë pikë.

8 Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja e Gucatit parashtroi se
9 Paneli duhet që të vijojë më tej me ndarjen e lëndës, me
10 procedurën e ndarjes së lëndës dhe vlerëson që i akuzuari e ka
11 kaluar kohën e nevojshme në burg deri në deklarin ose në
12 shqiptimin e gjykimit në fjalë.

13 Në këtë pikë, zoti Rees, a mund të na e bëni pak më të
14 qartë pozicionin tuaj, domethënë, çfarë sugjeroni në këtë
15 pikë?

16 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Parashtrimi që
17 bëj unë ose ftesa që bëj për Trupin Gjykses është që pa cenuar
18 parashtrimet e mia, pra, unë mendoj që zoti Gucati nuk është
19 fajtor për asnjë prej veprave për të cilat ai akuzohet.

20 Fakti që ne na është kërkuar të trajtojmë mundësinë e
21 dënimit për një ose më tepër vepra penale, pjesërisht,
22 demonstroi ose të paktën këtë kështu e kuptojmë neve, pra,
23 tani ne jemi jo në pozicion të favorshëm që të trajtojmë
24 dënimin. Dhe për këtë arsye, neve po mendojmë për të bërë
25 parashtrime për lehtësimin përpara sesa të jepet gjykimi.

1 Megjithatë kjo nuk është e vetmja bazë. Unë do të doja t'i
2 kërkoja gjithashtu Trupit Gjykses që ta shqyrtonte me kujdes
3 këtë parashtrim.

4 Baza kryesore e jona është që qasja e ndarjes së lëndës,
5 si e keni përshkruar ju të nderuar Gjykatës, duhet që të
6 përqafohet. Po ashtu, unë mendoj, që nuk ka asnjë rrethanë në
7 të cilën Trupi Gjykses mund të ushtrojë të drejtën e tij për
8 ta marrë vendimin menjëherë dhe unë kam propozuar një skenar
9 të mundshëm kur kjo mund jetë e përshtatshme. Një tjetër
10 skenar mund të ishte kur kemi të bëjmë me një vepër penale,
11 domethënë, me një akuzë të vetme në një moment të tillë mund
12 të parashikohet se me çfarë po merret Mbrojtja sa i takon
13 kësaj baze të vetme papërgjegjshmërie dhe një pike të vetme në
14 aktakuzë.

15 Megjithatë, ne nuk jemi në një situatë të tillë. Pra,
16 zoti Gucati ka një aktakuzë që përmban gjashtë pika dhe siç e
17 keni vërejtur më parë të nderuar Gjykatës, ka shumë baza të
18 shumëfishta alternative përgjegjshmërie të cilat janë
19 parashtruar nga Prokuroria.

20 Sa i takon veprave penale vetë, vepra të cilat rrjedhin
21 nga Kodi Penal i Kosovës, sa i takon fushës së veprimit të
22 saktë të këtyre veprave të ndryshme duhet përcaktuar ende dhe
23 do të duhet të që të ketë parashtrime të detajuara, të
24 hollësishme, sa i takon përbërësve ligjorë thelbësorë të së
25 cilës prej këtyre veprave dhe në vlerësimin tonë do të duhen

1 që të përcaktohen ende dhe të duhet që të vlerësohen nga Trupi
2 Gjykues. Ne nuk do të marrim vendimet e Trupit Gjykues sa i
3 takon fushës së veprimit të secilës prej këtyre veprave.

4 Dhe në këtë aspekt ka pasiguri ashtu siç edhe i takon dhe
5 disa pikave si dhe numrit alternativ të bazave të
6 përgjegjësisë së pretenduara.

7 Ne parashtrojmë që nuk është as praktike dhe as e drejtë
8 për të akuzuarit të paktën në këtë çështje - nuk e kemi fjalën
9 për të gjitha çështjet - kështu që nuk është e drejtë që të
10 kërkohet që të parashtrojmë, një reflektim të detajuar për
11 secilën prej bazave apo secilën prej pikave të cilat janë të
12 parashikuar në aktakuzë.

13 Ne thjesht ngremë skenarin alternativ në paragrafin 24 të
14 parashtrimeve tona mbi bazën se kur Trupi Gjykues, pra, kur të
15 dëgjojë deklaratat përmbyllëse është drejt fundit të procesit
16 gjyqësor dhe në këtë pikë është në pozitën për të gjykuar në
17 qoftë se personi ose i akuzuari është fajtor apo jo. Dhe
18 ndërkohë i akuzuari ose të akuzuarit janë në paraburgim dhe
19 ata kanë shërbyer për një kohë -- kanë qenë të mbajtur në
20 paraburgim për një periudhë të gjatë. Sigurisht, që ne nuk
21 është se jemi në pozitë, që domethënë, nuk është se duam që të
22 kundërshtojmë vendimin e Gjykatës së Trupit Gjykues por nga
23 ana tjetër mendojmë që në këtë situatë koha kur i akuzuari do
24 të mbahet i paraburgosur do të mund të zgjatet më tepër.

25 Megjithatë, e gjithë kjo që unë thashë është një situatë

1 hipotetike. E kemi ngritur këtë situatë hipotetike sepse ne
2 jemi ftuar që të shqyrtojmë sesi mund të trajtojmë një situatë
3 hipotetike, siç është situata aktualisht, pasi zoti Gucati
4 mund të shpallet fajtor për një ose më shumë pika të
5 aktakuzës.

6 Parashtrimi parësor i yni është që për shkak se çështja e
7 zotit Gucati ose aktakuza ndaj zotit Gucati ka të bëjë me
8 gjashtë pika dhe ka të bëjë me baza të ndryshme të shumëfishta
9 përgjegjësie, neve i kërkojmë Trupit Gjykses që të mbështetet
10 në rregullin 162 dhe 164.

11 Kjo është baza e parashtrimit tonë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

13 Faleminderit.

14 Zoti Cadman, ndonjë gjë për të shtuar?

15 Z. CADMAN: [Përkthim] Jam plotësisht dakord me atë çfarë
16 tha zoti Rees.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

18 Faleminderit.

19 Zonja Bolici.

20 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Prokuroria vlerëson që në pajtim
21 me rregullin 159(6), përcaktimi i dënimit të caktuar është
22 rregull ndërkohë që procedura e ndarjes së lëndës është
23 përjashtimi.

24 Në parashtrimin tonë, Mbrojtja nuk është se ka dhënë
25 rrethana specifike të cilat do të justifikonin ndarjen e

1 lëndës. Duke pasur parasysh që kemi të bëjmë me disa pika ose
2 pika të shumëfishta dhe mënyra të shumta përgjegjësie është
3 diçka e cila duhet të pritet mbështetur në procese penale
4 përpara gjykatave kombëtare. Faktet e kësaj çështjeje janë të
5 drejtpërdrejta, janë të thjeshta, kështu që në këtë kuadër
6 procedura e ndarjes së lëndës nuk është e nevojshme.

7 Një çështje që dëshiron të sjellë në vëmendjen tuaj
8 Prokuroria është që në kuadër të procedurës së dënimit, ZPS-ja
9 synon që të parashtrojë relevancën apo rëndësinë e shënimeve
10 zyrtare sa i takon dëshmitarëve të cilat janë deklaruar të
11 papranueshme për pjesën e gjykimit sepse janë vlerësuar se
12 bien nën rregullin 153 dhe 155.

13 ZPS-ja vlerëson që 161(1) i Rregullores, pra, ky rregull
14 i lejon palët që të parashtrojnë në kohën e dënimit material
15 apo informacion tjetër të rëndësishëm që i ndihmon palët për
16 të përcaktuar dënimin e përshtatshëm, ndërkohë që parimi i
17 oralitetit është i ndryshëm sa i takon kohës së ndryshme që
18 mund të jemi në procedurë mbi bazën e parashikimeve të
19 rregullit 162(4), që parashikon që vendimi duhet të bëhet
20 përmes procedurës me shkrim në qoftë se nuk parashikohet
21 ndryshe.

22 Arsyeja e vetme se pse Prokuroria shqyrton që ndoshta
23 ndarja e lëndës do të ishte e nevojshme në këtë rast ishte në
24 qoftë se Trupi Gjykses nuk do të ishte gatshëm që të dëgjonte
25 parashtrimet e këtyre materialeve së bashku me aktgjykimin. Në

1 këtë rast atëherë ishte e justifikuar procedura për ndarjen e
2 lëndës. Faleminderit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

4 Faleminderit, zonja Bolici.

5 Ndonjë gjë tjetër nga Paneli lidhur me këtë pikë?

6 Gjykatësi Mettraux.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi

8 Smith.

9 Zoti Rees dhe pastaj do t'i drejtohem zoti Cadman, kam dy
10 çështje që dua që dua që t'i sqaroni.

11 Çështja e parë ka të bëjë me kohëzgjatjen e parashtrimeve
12 të propozuara gojore. Juve kërkuat për gjashtë orë që të bënit
13 parashtrimet përfundimtare të Mbrojtjes dhe ju thatë që një
14 prej arsyeve kryesore pse e kërkon kaq kohë është që doni që
15 të jepni shpjegime për disa çështje të cilat nuk janë
16 shqyrtuar gjerësisht sa duhet gjatë procesit gjyqësor.

17 Dua që t'ju them në qoftë se gjëra të tilla nuk janë
18 dhënë me shkrim, në parashtrimet me shkrim? Domethënë, nuk e
19 di në qoftë se ka ndonjë arsye sepse këtë informacion nuk e
20 keni shtjelluar, nuk e keni parashtruar në seancat me gojë? A
21 ka pasur ndonjë gjë që ju ka parandaluar, nuk ju ka lejuar
22 ndoshta pjesërisht që ju të jepni parashtrimet e tuaja gjatë
23 procesit gjyqësor?

24 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Të nderuar
25 Gjykatës, sigurisht, që ne do të përpiqemi që parashtrimet me

1 shkrim t'i mbajmë sa më koncize të jetë e mundur. Po ashtu
2 edhe parashtrimet me gojë aq koncize sa të jetë e mundur.
3 Megjithatë, ka një vlerë për t'i bërë parashtrimet me gojë dhe
4 është parimi i oralitetit. Kështu që do të dëshiroja që në
5 prezantimin e deklaratës përmbyllëse të përfitoja nga ky
6 parim.

7 Dhe mua më duket që në emër të zotit Gucati është e
8 përshtatshme për mua që të kem kohë që të argumentoj disa prej
9 parimeve ligjore që ne do t'i ngremë dhe në fakt, i kemi ngrit
10 dhe i kemi shtjelluar dhe më përpara në parashtrimet me shkrim
11 dhe sërish, duke marrë parasysh edhe komentet e
12 Kryegjykatësit, pra, do të marrim, do të trajtojmë çështjet
13 kryesore duke mos i detajuar dhe duke mos i dhënë ato në shumë
14 hollësi. Por, megjithatë, kërkoj që të tërheq vëmendjen e
15 Trupit Gjykues për pjesë të provave materiale dhe të bëj
16 ilustrimet e nevojshme kur të jetë vendi.

17 Mua më duket sikur kjo është një çështje e rëndësishme,
18 është një pjesë e rëndësishme e parimit të oralitetit dhe këtë
19 e bëj kur të jem aty dhe domethënë, e bëj menjëherë dhe ju do
20 të keni mundësinë që të bëni ndërhyrje të menjëhershme, siç
21 keni bërë tani dhe e keni bërë përgjatë gjithë procesit
22 gjyqësor dhe do të kemi mundësi gjithashtu edhe t'i përgjigjem
23 pyetjeve që mund të më bëhen prej jush në mënyrë të
24 drejtpërdrejtë dhe do t'i jap mundësinë zotit Gucati që të
25 shikojë atë çfarë po ndodhë përpara tij.

1 Pra, do ishte më mirë që gjerat të bëhen me shkrim sesa
2 gjërat të jepen të ngjeshura në një dokument gjyqësor në një
3 parashtrim të protokolluar. Atëherë, të nderuar Gjykatës, unë
4 personalisht do preferoja më shumë që të kisha kohë në
5 dispozicion që t'i bëja parashtrimet me gojë më shumë sesa t'i
6 shkruaja gjërat në detaje dhe e mbështes një preferencë të
7 tillë dhe për këtë arsye më duhet që t'i drejtohem Trupit
8 Gjykses në detaje dhe shpresoj që Trupi Gjykses ta pranojë apo
9 ta shikojë pikëpamjen time, por, gjithsesi, do të doja t'ju
10 thoja që do mundohem që të mos humbas kohën tuaj të vyer.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Zoti Rees, askush nuk
12 mendon që ju po na humbni kohën dhe absolutisht asnjë nuk do
13 që të heq mundësinë që të flisni, që të respektoni parimin e
14 oralitetit. Ne duam t'ju japim mundësinë që ju të shpreheni,
15 pa diskutim.

16 Por pyetja ime është a ka ndonjë gjë që ju doni ta ngrini
17 me gojë që nuk mund ta vini në parashtrimet me shkrim,
18 domethënë, është thjesht një çështje baraspeshe, nuk është se
19 po them që të zgjidhni njërin me tjetrën.

20 Pra, ajo çfarë po dua t'ju pyes është që në qoftë se ju
21 keni shqetësime që ka aspekte të çështjes ose gjëra që kanë të
22 bëjnë me çështjen të cilat nuk mund të shkruhen me shkrim, nuk
23 mund të interpretohen, le të themi, në parashtrimet me shkrim
24 në më shumë hollësi dhe pastaj juve të mund të jepni një
25 interpretim të tyre më konciz me gojë?

1 Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, padiskutim që
2 unë do mundohem të jem konciz. Dua t'ju siguroj për këtë gjë.
3 Pra, kategorizimi i çështjeve është çështje balance,
4 baraspeshe. Dhe, sipas meje, është një çështje baraspeshe që
5 duhet që ta përcaktojë Mbrojtja, pra, për ta përcaktuar se ku
6 është kjo baraspeshë dhe që të bëjë masat e nevojshme në
7 mënyrë që të identifikojë mënyrën sesi është më mirë që të
8 parashtrojë dokumentin.

9 Pra, është një çështje baraspeshe. Pra, siç e thashë edhe
10 më përpara, do të mundohem që të mund të jem sa më konciz si
11 në parashtrimin me shkrim edhe me parashtrimet me gojë. Unë
12 mendoj që në këtë pikë të procedurës i takon Mbrojtjes që të
13 vlerësojë se si duhet të jetë, le të them, baraspesha ndërmjet
14 parashtrimeve me gojë dhe me shkrim.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk do të them ndonjë gjë
16 lidhur me këtë propozim të fundit të tuajin, zoti Rees. Do ta
17 lë me kaq.

18 Por dua që të sigurohem që e kam kuptuar siç duhet
19 parashtrimin tuaj sa i takon ndarjes së lëndës ose procesit të
20 ndarjes apo jo.

21 A kam të drejtë, a e kam kuptuar siç duhet që shqetësimi,
22 baza e shqetësimit tuaj është që ju doni të keni një kuptim të
23 qartë të natyrës së dënimit. Në qoftë se ju ose me fjalë të
24 tjera, domethënë, në qoftë se parashtrimi juaj për këtë pikë
25 nuk është i lidhur me dëshirën tuaj lidhur me provat që kanë

1 të bëjnë me çështjen. Pra, nuk ka të bëjë me natyrën e
2 vendimit tonë; a është e saktë kjo apo jo?

3 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Dua që të kem
4 qartësi, dua që të jem i qartë lidhur me atë çfarë do të
5 trajtohet lidhur me zotin Gucati në rast se ai do të shpallet
6 fajtor për ndonjërin ndër pikat e aktakuzës.

7 Për shembull, në qoftë se do të trajtojmë situatën
8 hipotetike, të nderuar Gjykatës, le ta mendojmë, që ka një
9 dënim ose disa dënime, pra, pasi të sqarojmë bazën, kjo do të
10 na bëjë ne të mundur që të japim prova të tjera për lehtësimin
11 sepse do ta kemi më të qartë se çfarë do të duhet të trajtojmë
12 lidhur me dënimin.

13 Dhe ne kemi të bëjmë me një aktakuzë e cila ka bazë të
14 shumëfishtë, që ka pika të shumta, pra, fushëveprimi i të
15 cilës nuk është se është kaq i qartë dhe duhet të sqarohet nga
16 Trupi Gjykses kështu që, në parashtrimin tonë, nuk është e
17 drejtë në raport me neve që të mundohemi që të hartojmë
18 parashtrimet për lehtësim dhe të shqyrtojmë se çfarë duam të
19 përdorim ose në qoftë se duam të përdorim material tjetër
20 plotësues në bazën hipotetike që dënimi mund të ketë lidhje me
21 një, dy, tre, katër, pesë apo gjashtë pika dhe mbi baza të
22 shumta të shumëfishta alternative të përgjegjësisë penale për
23 pikën një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë.

24 Singerisht, të nderuar Gjykatës, unë nuk mund ta
25 parashikoj sesi mund të trajtoj çështje të tilla gjatë pjesës

1 së lehtësimit. Pra, po flasim për -- mund të jetë shumë e
2 thjeshtë për ta bërë këtë gjë. Por çështja është që ne kaq
3 dimë dhe nuk jemi në një skenar të tillë ku mund të
4 parashikojmë shumë në këtë çështje.

5 Pra, me fjalë të tjera, të nderuar Gjykatës, ju po më
6 kërkonit në qoftë se unë mund të parashikoja që në qoftë se do
7 të kem mundësi për të kërkuar lehtësim të dënimit ose
8 trajtimit të të akuzuarit. Por nga ana tjetër unë mund t'ju
9 them në përgjigje që unë nuk mund t'ju them absolutisht asnjë
10 gjë sepse nuk e di sesi mund të trajtohet kjo çështje sepse
11 është e paparashikueshme se çfarë mund të vendoset prej jush,
12 të nderuar Gjykatës.

13 Në përgjigje të zonjës Bolici. Do të doja t'ju thosha që
14 Trupi Gjykues ka refuzuar që të pranojë në prova materiale
15 notat e kontaktit zyrtar. Dhe këto nota nuk janë pranuar në
16 prova materiale. Nuk mund të pranohen përpara sesa Trupi
17 Gjykues të shqiptojë vendimin e vet.

18 Me aq sa e kam kuptuar unë parashtrimin e ZPS-së, që
19 është që ata dëshirojnë ta ftojnë Trupin Gjykues që të marrin
20 parasysh çështje të tilla sa i takon dënimit, kjo mund të
21 bëhet vetëm mbështetur në rregullin 162, paragrafi 1, ose
22 ndoshta nuk mund të bëhet fare dhe mund të bëhet vetëm në
23 procedurën e ndarjes.

24 Unë nuk po ftoj që kjo të ndodhë tani, por parashtrimi që
25 bën zonja Bolici i jep zbatim kësaj dhe kjo mund të realizohet

1 vetëm në qoftë se qasja e ndarjes së çështjeve mund të
2 realizohet. Dhe siç e thashë edhe njëherë kemi të bëjmë me
3 shumë pika në aktakuzë, fushëveprimi i të cilës nuk është i
4 qartë. Kështu që do t'i kërkoja ZPS-së, që të jepte materiale
5 të tjera shtesë në qoftë se vendimi është shqiptuar kundër
6 zotit Gucati dhe të ndihmonte me lehtësimin.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe një gjë të fundit,
8 faleminderit, zoti Rees. Do t'i kthehem dhe Prokurorisë për
9 pak çaste në mënyrë që të mund të na e sqarojë pozicionin e
10 saj. Unë e kuptova parashtrimin e zonjës Bolici se procesi i
11 mosndarjes është norma dhe ndarja e lëndës është përjashtimi.

12 Pra, duke prezumuar që ky është rasti dhe për arsye të
13 kësaj pyetje që po ju bëj, a mund të themi që në këtë aspekt
14 ju mund të kishit thirrur ato prova materiale të cilat do të
15 ishin të rëndësishme ose që do ishin relevante për dënimin.
16 Çfarë do thoni juve në parashtrim në qoftë se zonja Bolici do
17 t'ju kishte dhënë këtë si shpjegim juridik ligjor?

18 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Të nderuar
19 Gjykatës, a mund të filloj duke e kundërshtuar propozimin që
20 bën zonja Bolici. Unë nuk pranoj që rregulli është rregulli që
21 parashikohet në 159(6) dhe ndërkohë ndarja ose ndarja e
22 procesit është përjashtimi.

23 Ndërkohë, sa i takon kësaj çështjeje, më duhet të them
24 nuk është se ka pasur ndonjëherë ndonjë rast tjetër që është
25 vendosur nuk është përcaktuar se cili është rregulli dhe cili

1 është përjashtimi dhe mendoj që duhet ende kohë të përcaktohet
2 se kush është rregullli dhe kush është përjashtimi për aq kohë
3 që Dhomat e Specializuara nuk janë shprehur ende për
4 fushëveprimin. Dhe nuk është ky rasti absolutisht në këtë
5 çështje.

6 Ajo çfarë dimë ne lidhur me rregullin 159, paragrafi 6,
7 është që në këtë rregull parashikohet që dënimi të vendoset me
8 shqiptimin e gjykimit të Trupit Gjykses në qoftë se nuk
9 vendoset ndryshe. Dhe pastaj thuhet që Trupi Gjykses vendos të
10 procedojë në përputhje me rregullin 162, gjë e cila i jep një
11 diskrecion të madh. Kështu që baza e diskrecionit është që
12 palët kanë të drejtë që t'i japin parashtrimet e tyre.

13 Pra, me fjalë të tjera, paragrafi 6 i rregullit 159, i
14 ofron një fushë të gjerë veprimi Trupit Gjykses në mënyrë që
15 të mund ta shpallë fajtor ose të shqipërojë fajësinë e të
16 akuzuarit ose të vendosë për një gjë të tillë më vonë.

17 Ndërkohë që sa i takon asaj çfarë pyetët ju, të nderuar
18 Gjykses, në qoftë se gjithë materiali relevant është dhënë.
19 Përgjigja për këtë është që unë nuk e di, sepse në këtë fazë
20 të procedimit unë ende nuk e di në qoftë se zoti Gucati do të
21 shpallet fajtor për një ose më shumë vepra dhe mbi çfarë
22 bazash. Në këtë fazë unë nuk e di se cila është përbërja
23 thelbësore e veprave penale që do të përcaktohen, do të
24 vendosen nga Trupi Gjykses.

25 Ky nuk është një koncept i pazakontë dhe për qëllimet e

1 fajësisë apo pafajësisë së të akuzuarit edhe sa i takon
2 gjithashtu edhe materialit që është i rëndësishëm për
3 çështjen, për shembull, në lidhje me rrethanat personale të
4 cilat mund të jenë rrethana lehtësuese dhe të cilat nuk kanë
5 të bëjnë me shqiptimin fajtor apo jo të të akuzuarit dhe që
6 nuk janë parashtruar gjatë procesit gjyqësor.

7 Pra, nuk e pranoj propozimin e parashtruar nga zonja
8 Bolici. Dhe, së dyti, nuk mund t'ju them të nderuar Gjykatës
9 që të gjitha çështjet e rëndësishme që do të donim që t'ia
10 parashtronim Trupit Gjyqësor për dënimin, nuk janë bërë gjatë
11 gjykimit. Pra, me fjalë të tjera, kjo është mënyra sesi
12 funksionon procesi gjyqësor dhe lehtësimi.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

14 Zoti Cadman, përpara se t'i drejtohem Prokurorisë?

15 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo, Zoti Rees i mbuloi përkatësisht
16 të gjitha pikat që unë do të paraqisja.

17 E vetmja gjë që mund të shtoj lidhur me Mbrojtjen e zotit
18 Haradinaj. Lidhur me ekuilibrin midis parashtrimeve gojore dhe
19 me shkrim, duke pasur parasysh kohën që ka kërkuar zoti Rees,
20 sigurisht, ne do të përpiqemi që të jemi sa më të përmbledhur
21 në parashtrimet tona me shkrim dhe ato me gojë do të jenë një
22 përmbledhje e atyre që kemi paraqitur me shkrim. Dhe këto do
23 t'i mbajmë në minimum.

24 Me kusht që zoti Rees t'i jepet koha që ka kërkuar, mbase
25 unë mund ta shkurtoj kohën që kam kërkuar nga gjysëm dite në

1 një seancë, por gjithçka varet nga paraqitja e Mbrojtjes së
2 Gucatit, të cilin në këtë fazë unë nuk e parashikoj dot.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

4 Zonja Bolici keni diçka për të thënë lidhur me
5 parashtrimet e zotit Rees për çështjen në fjalë? Diçka që
6 duhet ta them që nuk e pata të qartë dhe me sa duket dhe zoti
7 Rees nuk e ka të qartë, nëse ju planifikoni apo propozoni të
8 mbështeteni në materiale që nuk janë paraqitur si prova
9 materiale për qëllimet e dënimit apo e kemi keqkuptuar?

10 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po. Lidhur me dënimin, qëndrimi
11 ynë është që palët mund të përdorin materialet të papranuara
12 ende që janë në fakt paraqitur për praninë dhe nuk janë pranuar
13 dhe kjo bazohet në rregullin 160(2). Një minutë, sa ta gjej.
14 Bazohet në rregullin 162(1) që i lejon palët të paraqesin
15 informacion përkatës që e ndihmon Panelin të përcaktojë
16 dënimin e duhur.

17 Pra, qëndrimi ynë është se në kuadrin e një procedure të
18 ndarë, palët lejohen të paraqesin parashtrimet e tyre për
19 dënimin lidhur me materiale, informacion të ndryshëm nga ato
20 që janë paraqitur si prova materiale.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Një minutë. Nëse ju kuptoj
22 drejtë dhe mbase kjo ndihmon edhe zotin Rees, nëse do të
23 vendosnim të ndiqnim një proces jo të ndarë, atëherë do të
24 kërkohej që të kërkonit të bënit një kërkesë ju për dokumente
25 shtesë të pranuar, duke përfshirë notat që ne refuzuam t'i

1 pranojmë si pjesë e çështjes? Këtë doni të thoni?

2 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Nuk do të bënim kërkesë për
3 pranimin e këtyre materialeve si prova materiale. Thjesht, një
4 parashtrim informacioni si mbas rregullit 162(1). Pra, marrë
5 rrethanat të cilat mund të përdoren vetëm për qëllimet e
6 dënimit. Në këtë rast nuk ka nevojë që të paraqiten si prova,
7 të pranohen si prova. Vetëm për këtë qëllim do të kërkonim të
8 përdornim informacione të tjera nga ato që janë pranuar si
9 prova.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, ju pranoni faktorin
11 rëndues nëse ju doni ta paraqisni, po të kishte po të bëhej
12 fjalë për dënim, duhet të provoni standardin e të vërtetës
13 përtej dyshimit të arsyeshëm. E pranoni këtë?

14 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po, e pranojmë. Po natyra ligjore
15 që ka të bëjë me informacionin e përdorur vetëm për qëllimet e
16 dënimit. Në këtë kuadër rregulli 162(1), si edhe procedura e
17 theksuar në rregullin 162(4), që thotë "Dënimi përcaktohet
18 duke u bazuar në parashtrime me shkrim përveçse Trupi Gjykses
19 ka vendosur ndryshe". Vetëm në këtë rast.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, për mendimin tuaj, në
21 mund të bëjmë një konstatim lidhur me dyshimin e arsyeshëm për
22 informacione të papranuara?

23 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po. Duhet të provohet përtej
24 dyshimit të arsyeshëm. Faktorët rëndues mund të varen nga
25 shumë rrethana. Në parashtrime se faktorët rëndues mund të

1 përcaktohen bazuar në informacione të tjera nga ato të
2 pranuar si prova.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Keni ndonjë autoritet
4 tjetër përveç leximit tuaj? A njihni ndonjë sistem ligjor apo
5 ndonjë jurisprudencë në botë që përdoret kjo gjë?

6 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kjo është mënyra si e
7 interpretojmë ne rregullin 162(1). Nëse kërkoni burime të
8 tjera autoritative mund t'jua japim.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Një
10 minutë, zoti Rees.

11 Kërkoj që të merrni parasysh faktin që ka një farë
12 dallimi midis një dokumenti që nuk është pranuar dhe një
13 dokumenti për të cilin është vendosur që është i papranueshëm
14 nga Gjykata. Kjo është një nga gjërat me të cilën po përpiqemi
15 të gjejmë zgjidhje. Ju propozoni diçka që nuk është paraqitur
16 nga një person por pranohet nga një dokument që dikush tjetër
17 e ka hartuar. Dhe ky ka qenë problemi me të vërtetën e
18 çështjes prandaj nuk u pranua pikë së pari. Kështu që kjo vlen
19 edhe për rastin -- çështjen e dënimit.

20 Prandaj dhe ne nuk e kemi shumë të qartë. Nëse doni të
21 bëni një parashtrim, mund ta bëni.

22 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Parashtrimi bazohet thjeshtë në
23 rregulli 162(1) dhe mundësia e përdorimit të informatave të
24 tjera. Për shembull, Mbrojtja e Gucatit ka përdorur të tjera
25 parashtrime. Pra, ato kanë marrë parasysh faktorët personalë

1 me rëndësi për përcaktimin e dënimit i cili mund të ndikojë në
2 Trupi Gjykses në përcaktimin e dënimit të duhur. Prandaj, neve
3 themi që dokumentet nuk janë pranuar nëpërmjet mocioneve nga
4 tavolina. Janë informacione që mund të kenë ndikim në dënimin.
5 Në këtë rast, ne themi që duhet marrë parasysh një
6 informacioni tillë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti Rees,
8 keni ndonjë koment për të bërë?

9 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po. Zonja
10 Bolici thotë që ajo përdor rregullin 162(1). Për mua është
11 shumë e qartë se rregulli 162(1) nuk zbatohet kur shqiptohet
12 dënimi në bazë të rregullit 159(6). Kjo e thotë shprehimisht,
13 ai zbatohet vetëm kur Trupi Gjykses vendos të veprojë në bazë
14 të rregullit 162 dhe 164.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
16 Faleminderit.

17 Më falni, është Gjykatësi Gaynor ka një pyetje.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit shumë,
19 Gjykatësi Smith.

20 Zonja Bolici, dua t'i kthehem përsëri kuptimit të
21 shprehjes "çdo informatë me rëndësi që mund të ndihmojë Trupin
22 Gjykses për të dhënë dënimin e duhur" që është pjesë e
23 rregullit 162 që ju iu referuat.

24 Nëse jepet një dënim, Trupi Gjykses do të ishte i
25 interesuar të dëgjonte prova që lidhen me faktorë zbutës,

1 lehtësues të cilët përcaktohen në bazë të probabilitetit apo
2 të faktorëve rëndues të cilët duhen vërtetuar përtej dyshimit
3 të arsyeshëm.

4 E pranoni se mund të ketë një qasje disi të ndryshme
5 midis Mbrojtjes dhe Prokurorisë. Mbrojtja mund të dojë të
6 parashtrojë parashtrime me shkrim që jo patjetër -- që
7 mbështeten kryesisht në rregullat 153, 154 dhe 155. Ndërsa
8 Prokuroria, në qoftë se do të vendosi të vërtetojë standardet
9 rëndues duhet të zbatojë një tjetër standard. Pra, pajtoheni
10 me mua që ky do të ishte një interpretim i arsyeshëm i
11 formulimit #çdo informacion me rëndësi që mund ta ndihmonte
12 Trupi Gjykses parashikuar në rregullin 162"?

13 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Jo. Nuk pajtohem me këtë qëndrim
14 në këtë fazë. Duke marrë parasysh se rregulli 162 nuk bën
15 ndonjë dallim në këtë drejtim dhe ne nuk u referohemi
16 rrethanave rënduese por faktorëve rëndues që do të --
17 rrethanave të cilat duhen marrë parasysh për të vlerësuar
18 dënimin që do të ishte i përshtatshëm në rrethanat konkrete.
19 Jo si pjesë e elementeve të krimeve të cilat duhen provuar
20 përtej dyshimit të arsyeshëm, por si elementë që duhen marrë
21 parasysh për vlerësimin e marrjes së vendimit të duhur.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po a nuk duhen edhe faktorët
23 rëndues të provohen përtej dyshimit të arsyeshëm? Nuk e
24 pranoni këtë?

25 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po. Në lidhje me informacionin që

1 lidhet me dënimin, që ka rëndësi për dënimin, provat nuk duhen
2 marrë bazuar në të njëjtat kufizime që zbatohen në lidhje me
3 rregullin 139. Lidhur me dëshmitë, prova e pranuar për
4 qëllimet e vërtetimit të fajësisë apo pafajësisë së të
5 akuzuarit.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ky ishte
8 gjithë programi për sot. Jam në rregull apo kemi diçka tjetër.
9 Faleminderit shumë për sinqeritetin, për bashkëpunimin, për
10 parashtrimet. Do të bëjmë çmos që të lëshojmë një urdhër sa më
11 shpejtë që të jetë e mundur. Faleminderit që iu përgjigjët dhe
12 kërkesës për miratim dhe e bëtë këtë punë sa më shpejtë. Tani
13 e ndërpresim sot punën.

14 Këtu mbarojmë për sot. Pra, do të dëgjoni nga ne me
15 shkrim.

16 --- Konferenca për ecurinë e çështjes përfundon
17 në orën 10.42 paradite

18

19

20

21

22

23

24

25